



Duke u bazuar në nenin 12 paragrafi 12.2 pika d) si dhe nenit 40.paragrafi 40.2 shkronja c) të Ligjit për Vetqeverisjen Lokale nr.03/L-040, nenit 17, 38, 60 dhe 61 Ligjit për Financa Publike dhe Pergjegjesit nr 05/L-1007 i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr.03/L-048 nenit 7 dhe 8 të Rregullorës Komunale Për Ndarje të Subvencione dhe Transfereve Nr 06-4043/2015 , nenit 16 paragrafi 8 pika 8.2 i Ligjit Nr. 08/L-193 mbi ndarjet buxhetore për buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2023, nenit 92 të Statutit të Komunës, me kërkesën e drejtoris për Financa Ekonomi dhe Zhvillim si dhe me rekomandimin e KPF-së, Kuvendi i Komunës në mbledhjen e rregullt të mbajtur më datë: 27.10.2023.mori këtë:

V E N D I M

Për shtim të buxhetit dhe krijimin e kodit të ri për participim

1. Aprovohet propozim-vendimi i Drejtorisë për Financa, Ekonomi dhe Zhvillim për shtim të buxhetit dhe krijimin e kodit të ri për "Fasadimi i objekteve të vjetra në qytet" në shumën prej: 5,000.00 (pesëmijë) euro - kategoria ekonomike shpenzimet kapitale.
2. Projekti i ri do të krijohet me mjetet nga participimi i qytetarëve bazuar në marrëveshjen e mirëkuptimit në mes të komunës dhe qytetareve, emri i projektit "Fasadimi i objekteve të vjetra në qytet".
3. Komuna financon me mjete financiare në shumë prej 44,444.00 euro nga kategoria ekonomike shpenzimet kapitale, nga kodi i projektit bashkëfinancim me donatorë (48267), nën programi Planifikimi Urban dhe Mjedisi(66395), fondi 21, kurse qytetarët kanë participuar me 5,000.00 euro, vlera e tërësishme e projektit është 49,444.00 euro.
4. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Kryetari i Komunës në bashkëpunim me Drejtorin për Financa, Ekonomi dhe Zhvillim.
5. Ky vendim hyn në fuqi pas miratimit nga Kuvendi i Komunës, sipas rregullores (QRK) Nr.06/2021 për ndryshimin dhe plotësimin e rregullores (QRK) Nr. 10/2019 për shqyrtimin administrativ të akteve të komunave dhe pas publikimit në ueb faqen zyrtare të Komunës.
6. Me këtë vendim njoftohen: MAPL, Kryetari i Komunës, Drejtoria për Financa, Ekonomi dhe Zhvillim, Zyra për Informim dhe Arkivi i Komunës.

KUVENDI I KOMUNËS KLINË

01Nr. 16-37386 /2023
Klinë, më 01.11 /2023



Kryesuesi
Fadil Gashi